

# Azilkërkuesit në Shqipëri

## Viti 2019

**Tiranë, më 21 gusht 2020:** Në 2019 rezultojnë 6.557 azilkërkues në Shqipëri, duke pësuar rritje me 49,5 %, krahasuar me 2018.

Azilkërkuesit me origjinë nga Iraku dhe Siria zënë 62,4 % të azilkërkuesve gjithsej në 2019 dhe rezultojnë 2.408 azilkërkues nga Iraku dhe 1.682 azilkërkues nga Siria.


Në 2019 rezultojnë 485 persona të cilët kanë fituar shtetësi shqiptare, duke pësuar rritje me 40,6 %, krahasuar me vitin 2018.

Gjatë vitit 2019 rezultojnë të jenë 741 persona, të cilët kanë humbur shtetësinë shqiptare, duke pësuar rritje me 15,8 %, krahasuar me vitin 2018.

## Azilkërkuesit në Shqipëri

Azilkërkuesit në Shqipëri, referuar Drejtorisë së Azilit dhe Shtetësisë pranë Ministrisë së Brendshme, rezultojnë 6.557 persona në 2019. Duke analizuar vendin e origjinës së azilkërkuesve, në 2019 kuptojmë se shumicën e rasteve e përbëjnë ato me origjinë nga Iraku me 2.408 azilkërkues, Siria me 1.682 azilkërkues, Maroku me 576 azilkërkues, Algjeria me 499 azilkërkues, Pakistani me 275 azilkërkues dhe nga Afganistani me 269 azilkërkues.

Fig. 1 Azilkërkuesit kryesor sipas vendit të origjinës, 2018 – 2019




Burimi: Drejtoria e Azilit dhe Shtetësisë, Ministria e Brendshme

**Për publikim 21 gusht 2020**

Vijon:

Po të analizojmë të dhënat sipas gjinisë, vëmë re se numri i azilkërkuesve femra në 2019 është 5.266, ndërsa i meshkujve është 1.229. Vihet re një dominim i femrave në numrin e azilkërkuesve në Shqipëri për 2019 me 80,3 % të numrit gjithsej të azilkërkuesve.

**Fig. 2 Kërkesat për azil sipas gjinisë, 2019**




Burimi: Drejtoria e Azilit dhe Shtetësisë, Ministria e Brendshme

\*Kategoria "Të panjohur" nënkupton rastet e azilkërkuesve, për të cilat informacioni mbi gjininë mungon

Duke parë kërkesat për azil sipas muajve, kuptojmë se piku i aplikimeve ka qenë në muajt Shtator-Nëntor, të cilët përbëjnë 39,2 % të azilkërkuesve gjithsej.

**Fig. 3 Kërkesat për azil sipas muajve, 2019**



Burimi: Drejtoria e Azilit dhe Shtetësisë, Ministria e Brendshme

Gjatë 2019 rezultojnë 24 vendime pozitive për dhënie të statusit të refugjatit dhe statusit të mbrojtjes plotësuese për azilkërkuesit, dhe pjesën më të madhe e zënë shtetasit nga Iraku dhe Siria.

### **Marrja dhe lënia e shtetësisë Shqiptare**

Në 2019 rezultojnë 485 persona të cilët kanë fituar shtetësi shqiptare, duke pësuar rritje me 40,6 %, krahasuar me vitin 2018.

Në 2019, rezultojnë 741 persona të cilët kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare, duke pësuar rritje me 15,8 %, krahasuar me vitin 2018.

**Tab. 1 Marrja, lënia, njohja dhe rifitimi i shtetësisë Shqiptare**

Viti	2017	2018	2019
Fitim shtetësie	316	345	485
Lënie shtetësie	651	640	741

*Burimi: Drejtoria e Azilit dhe Shtetësisë, Ministria e Brendshme*

# Metodologjia

Qëllimi i publikimit vjetor për azilkërkuesit në Shqipëri është paraqitja e rezultateve dhe treguesve për azilkërkuesit në Shqipëri sipas gjinisë, muajit të aplikimit, vendeve të origjinës, si dhe numrin e individëve që kanë marrë dhe lënë shtetësinë Shqiptare.

Të dhënat mbi Azilkërkuesit dhe fitimit ose lënies së shtetësisë në Shqipëri sigurohen nga Drejtoria e Azilit dhe Shtetësisë, në Ministrinë e Brendshme.

## **Përkufizime:**

**Azil** është forma e mbrojtjes ndërkombëtare që Republika e Shqipërisë u jep refugjatëve.

**Azilkërkues** është çdo i huaj apo person pa shtetësi, që shpreh në çfarëdolloj mënyre se nuk dëshiron të kthehet në vendin e tij, si dhe çdo i huaj apo person pa shtetësi që ka paraqitur një aplikim për azil në Republikën e Shqipërisë, për të cilin nuk është marrë ende një vendim përfundimtar.

**Aplikim për azil** është kërkesa zyrtare e të huajit ose personit pa shtetësi para autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, e cila vlerësohet si një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, sipas Konventës së Gjenevës së OKB-së, "Mbi statusin e refugjatit". Çdo kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare vlerësohet si aplikim për azil, përveç rastit kur i huaji kërkon qartazi një lloj tjetër mbrojtjeje, për të cilën aplikohet veçmas.

**Kërkesë për azil** është çdo deklaratë e të huajit ose personit pa shtetësi, e shprehur në çfarëdolloj mënyre e në çfarëdo kohe përpara autoriteteve kompetente, në pikat e kalimit kufitar apo brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, i cili kërkon mbrojtje ndërkombëtare, sipas konventave ndërkombëtare dhe legjislacionit shqiptar.

**Shtetësia shqiptare** fitohet, rifitohet, humbet apo lihet në përputhje me dispozitat ligjore për shtetësinë shqiptare, të cilat respektojnë normat e parimet e njohura të së drejtës ndërkombëtare në fushën e shtetësisë, të pranuar nga Republika e Shqipërisë.

**Shtetësia shqiptare fitohet** me: a) lindje; b) natyralizim; c) birësim

**Marrja e shtetësisë** fitohet nga një i huaj që ka paraqitur kërkesë për marrjen e shtetësisë shqiptare, në rast se plotëson kushtet e paracaktuara në ligj.

**Lënia e shtetësisë shqiptare** nënkupton se pasja e shtetësisë shqiptare merr fund sipas kërkesës së personit, kur ai plotëson kushtet e paracaktuara në ligj.

**I huaj** është çdo person, me ose pa shtetësi, i cili, sipas legjislacionit shqiptar, nuk është shtetas shqiptar.

**Person pa shtetësi** është personi, i cili nuk ka shtetësinë e asnjë shteti.

**“Refugjat”** është i huaji apo personi pa shtetësi, i cili, për shkak të frikës së bazuar të persekutimit, për arsye të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike, ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së tij ose vendit të zakonshëm të banimit dhe nuk ka mundësi ose dëshirë për të kërkuar mbrojtjen e atij vendi apo kthimin në atë vend, si pasojë e këtyre rrethanave, në përputhje me kriteret e nenit 1(A) të Konventës së Gjenevës.

**Shtet apo vend i origjinës** është shteti, shtetësinë e të cilit mban azilkërkuesi apo refugjati dhe, në rastin e personave pa shtetësi, shteti në të cilin refugjati apo azilkërkuesi ka vendbanimin e tij të zakonshëm.

**Status i mbrojtjes plotësuese** është njohja nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët në Republikën e Shqipërisë i të huajit ose personit pa shtetësi, si person i pranueshëm për mbrojtje plotësuese.

**Status i refugjatit** është njohja nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët në Republikën e Shqipërisë i shtetasit të huaj ose personit pa shtetësi si refugjat.